



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1029/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Patron” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811254792 dhe me seli në Miradi, Komuna e Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.S., avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 141/23, i lejuar më datë 09.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 02.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Patron” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811254792, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 141/23, i lejuar më datë 09.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 141/23, i lejuar më datë 09.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, mbi bazën e dokumentit përmbartimor; Vendimit 01Nr.09-190-V/2022, të datës 23.11.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 141/23, të datës 09.06.2023 me të cilin është obliguar debitori “Patron” Sh.P.K., që menjëherë pas pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 4.800.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetim se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 71, pika 1.1 të LPP-së, sepse dokumenti në bazë të

të cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Poashtu, ka theksuar se debitori ka paraqitur padi për inicimin e konfliktit administrativ në gjykatë për kontestimin e vendimit mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave proceduralë dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Në fund, ka theksuar se propozimi për përmbartim është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së, ndërsa gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri përmbartimor është lejuar mbi bazën e vendimit që është i përmbartueshëm dhe i ekzekutueshëm, duke kundërshtuar kështu pretendimet e debitorit për mungesë të bazës juridike për përmbartim dhe se procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se ushtrimi i padisë në procedurën e konfliktit administrativ nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi 01 Nr.09-190-V/2022, i datës 23.11.2022, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, është bërë i

plotfuqishëm dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 19.05.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se ndaj vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor ka iniciuar konflikt administrativ për shkak se i njejt i përmbarues shkelje të dispozitave procedurale dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase padia e paraqitur në gjykatë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për konfliktet administrative, me të cilin përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1029/23, datë 02.11.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.